VENDIM
Nr.34, datë 25.7.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i “	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i “	“
Vitore Tusha	Anëtare	e “	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i “	“
Sokol Berberi	Anëtar	i “	“
Admir Thanza	Anëtar	i “	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e “	“
Vladimir Kristo	Anëtar	i “	“

me sekretare Blerina Çinari, në datat 10.3.2011 dhe 14.4.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 4 Akti që i përket:

KËRKUES: Shefit Kadriu

SUBJEKT I INTERESUAR: 1. CEZ SHPËRNDARJE, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.751, datë 10.4.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimi i çështjes për rigjykim.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, kërkuesin që kërkoi pranimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me vendimin nr.6, datë 5.3.2007 të Drejtorit të Divizionit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Zona e Burrelit, të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare është bërë shkëputja e marrëdhënieve të punës ndërmjet kërkuesit dhe ndërmarrjes së sipërpërmendur.

Kërkuesi ka ankimuar vendimin e sipërpërmendur të pushimit te Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Dibrës, e cila me vendimin nr.225, datë 2.5.2007 ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

Vendimin e mësipërm, të gjykatës së shkallës së parë, kërkuesi e ka ankimuar pranë Gjykatës së Apelit të Tiranës, e cila me vendimin nr.751, datë 10.4.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.225, datë 2.5.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Dibrës.

Kërkuesi ka ushtruar rekurs te Gjykata e Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimit nr.751, datë 10.4.2008 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe pranimin e kërkesëpadisë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2010-85, datë 11.2.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit në Dhomë Këshillimi.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, për arsye se, nga ana e Gjykatës së Apelit të Tiranës, i është mohuar e drejta për të marrë pjesë në gjykim, e sanksionuar nga neni 42/2 i Kushtetutës. Sipas tij, Gjykata e Apelit të Tiranës, në kundërshtim me detyrimet që burojnë nga neni 460 i Kodit të Procedurës Civile, nuk ka bërë njoftimin për ditën dhe orën e gjykimit me shpallje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Dibrës dhe, për rrjedhojë, nuk ka marrë dijeni për zhvillimin e gjykimit. Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë plenare kërkuesi i shtoi objektit të kërkesës edhe shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2010-85, datë 11.2.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur prej tij.

Kërkuesi legjitimohet *ratione materiae* për arsye se, në përputhje me nenet 131/f dhe 134/g të

Kushtetutës, Gjykata shqyrton kërkesat e individëve për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Kërkuesi legjitimohet, gjithashtu, *ratione temporis* për arsye se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

Gjykata vendosi të thërrasë me cilësinë e subjektit të interesuar "CEZ Shpërndarje" meqenëse pas kontratës së lidhur me Këshillin e Ministrave, më datë 11 mars 2009, kësaj kompanie (e quajtur fillimisht "CEZ Group" dhe duke filluar nga datë 1.10.2010 "CEZ Shpërndarje") i kanë kaluar kompetencat që kishte më parë "Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare", në vartësi të së cilës ishte Divizioni i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, zona e Burrelit.

II

Për cenimin e së drejtës për të marrë pjesë në gjykim dhe parimit të kontradiktoritetit të garantuar nga neni 42/2 i Kushtetutës

Gjykata, në jurisprudencën e saj konstante, ka përcaktuar disa standarde kushtetuese të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi, për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë, në raport me palën kundërshtare.

E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim, i paraprin të drejtave të tjera, pasi, nëse pala ndërgjygjëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat e sipërpërmendura, të cilat i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor.

Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se "Rekursi që ushtrohet ndaj vendimit të gjykatës së apelit, i duhet njoftuar palës së interesuar, për t'i dhënë asaj mundësi për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë dhe për t'u mbrojtur". Në rastin në shqyrtim, moskomunikimi i rekursit i ka mohuar kërkuesit të drejtën e pjesëmarrjes në gjykim në gjykatë dhe të mbrojtjes, çka e bëri procesin të parregullt në kuptimin kushtetues. Privimi i palës në proces nga mundësia, që nëpërmjet përfaqësimit të mbrojë interesat e veta në gjykim, është konsideruar shkelje e standardeve të procesit të rregullt në shumë vendime të Gjykatës Kushtetuese" (*shih vendimin nr.34 datë 03.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'i garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por përkundrazi duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre.

Në këtë aspekt, një rol të veçantë ka luajtur edhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila e ka ngritur parimin e kontradiktoritetit në nivelin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke e konsideruar si një element të domosdoshëm të një gjykimi të drejtë (*shih Vermeulen k. Belgjikës, vendimi i datës 20 shkurt 1996 § 33, Nideröst-Huber k. Zvicrës, vendimi i datës 18 shkurt 1997, § 24*).

Gjykata, në jurisprudencën e saj, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit, ndonëse nuk gjendet i shprehur në mënyrë eksplicite në normat kushtetuese. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin civil, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor.

Për sa më sipër, duke qenë se për parimin e barazisë së armëve ka një jurisprudencë konstante

dhe të konsoliduar të Gjykatës, nuk mund të vihet më në dyshim se ky parim është tashmë një garanci kushtetuese e cila shfaqet si pjesë integrale e garancisë për një proces të rregullt ligjor. (shih vendimet: nr.5, datë 17.2.2003; nr.33, datë 24.11.2003; nr.16, datë 8.6.2006; nr.13, datë 21.7.2008; nr.28, datë 2.10.2009; nr.30, datë 26.11.2009; nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese).

Parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në gjykim, është një parim i cili është pjesë e domosdoshme qoftë e procesit penal, ashtu edhe civil. Për sa më sipër, edhe pse parimi i kontradiktoritetit mund të zhvillohet më shumë nga doktrina dhe jurisprudenca në fushën penale, ku ky i fundit është pjesë e të drejtës së mbrojtjes të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës, është përsëri i zbatueshëm në procesin civil, pasi ky proces duhet të garantojë barazi substanciale të palëve dhe është e padiskutueshme që kontradiktoriteti efektiv midis palëve e arrin këtë qëllim.

Kështu, Gjykata ka theksuar se "Në shqyrtimin e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese përqendrohet vetëm në ato pretendime që kanë të bëjnë me parimet themelore të procesit gjyqësor civil. Në këtë kuadër ka rëndësi të shqyrtohet pretendimi për shkeljen e parimit të barazisë së armëve në proces, si dhe pretendimi për shkeljen e parimit të sigurisë juridike si një aspekt i parimit të shtetit të së drejtës.

Me këtë rast Gjykata thekson se barazia e armëve është një aspekt i rëndësishëm i konceptit të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Ky parim nënkupton që secilës palë në proces t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet (ku përfshihet edhe paraqitja e provave nga ana e saj), në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të dukshëm në raport me palën tjetër." (*shih vendimin nr.23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Siç rezulton nga dosja gjyqësore, zhvillimi i Gjykimit në Gjykatën e Apelit të Tiranës është zhvilluar pa praninë e palëve. Neni 460 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se njoftimi i gjykimit bëhet me shpallje te gjykata e apelit që ka në shqyrtim çështjen dhe te gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin e ankimuar. Nga vërtetimi i dërguar nga kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Dibrës, si dhe nga materialet e administruara në seancë, u provua se njoftimi për datën dhe orën e gjykimit, në kundërshtim me dispozitën procedurale si më lart, nuk është shpallur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Dibrës, ku ka vendbanimin kërkuesi.

Gjykata vlerëson se ishte detyrë e Gjykatës së Apelit të Tiranës të verifikonte nëse njoftimi i palëve ishte bërë në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me nenin 460 të Kodit të Procedurës Civile, çka ajo nuk e ka bërë.

Gjykata vëren, gjithashtu, se ndonëse pretendimi si më sipër është ngritur nga kërkuesi edhe në rekursin e tij dërguar Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ky i fundit, në vendimin nr.00-2010-85, datë 11.2.2010 jo vetëm nuk e ka vlerësuar, por as është shprehur për të, duke vendosur mospranimin e rekursit në Dhomë Këshillimi.

Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mohimit të së drejtës së tij për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes, objekt shqyrtimi, në Gjykatën e Apelit të Tiranës, për shkak të mosnjoftimit të datës dhe orës së gjykimit, janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja "f" dhe nenit 134 shkronja "g" të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.751, datë 10.4.2008 të Gjykatës së Apelit të Tiranës.
- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2010-85, datë 11.2.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Tiranës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol